



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.165**

**13 dhjetor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 349 datë 11.11.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Kartën e Organizatës për Mirëmbajtjen dhe Furnizimin e NATO-s (NAMSO), 1958 ..... 8567
Udhëzim i METE dhe MF nr.1, datë 22.11.2010	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”..... 8583

**LIGJ**  
**Nr.10 349, datë 11.11.2010**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KARTËN E ORGANIZATËS PËR  
MIRËMBAJTJEN DHE FURNIZIMIN E NATO-S (NAMSO), 1958**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Kartën e Organizatës për Mirëmbajtjen dhe Furnizimin e NATO-s (NAMSO), 1958.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6781, datë 23.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

REGJISTËR HISTORIK  
KARTA E NAMSO-S

Rishikimi i dytë i Kartës së NAMSO [PO/2000/167, 30 gusht 2000] miratuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut më 15 shtator 2000 (Dokumenti i veprimit për PO/2000/167, 27 shtator 2000)  
Ndryshimi nr.1 [PO(2005)0066, 7 korrik 2005], miratuar nga NAC më 29 korrik 2005  
(Dokumenti i veprimit për PO(2005)0066, 1 gusht 2005)  
Ndryshimi nr.2 [PO(2006)0077, 18 korrik 2006 dhe PO(2006)0077-COR1, 19 korrik 2006], miratuar nga NAC më 4 gusht 2006  
(Dokumenti i veprimit për PO(2006)0077, 7 gusht 2006)  
Ndryshimi nr.3 [PO(2007)0083, 6 shtator 2007], miratuar nga NAC më 28 shtator 2007  
(Dokumenti i veprimit për PO(2007)0083, 1 tetor 2007)  
Ndryshimi nr.4 [PO (2009) 0145, \_\_\_\_\_], miratuar nga NAC më \_\_\_\_2009  
(Dokumenti i veprimit për PO (2009)0145 \_\_\_\_2009)

Data e hyrjes në fuqi:  
28 shtator 2007

BORDI I DREJTORËVE  
KARTA E ORGANIZATËS SË MIRËMBAJTJES DHE FURNIZIMIT TË NATO (NAMSO)  
(KARTA E NAMSO-S)

Parathënie

- *Duke pasur parasysh* Kartën mbi sistemin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe furnizimit të NATO-s, miratuar më 21 maj 1958 [Referenca: C-M(58)78 dhe C-R(58)36];
- *Duke pasur parasysh* ndryshimin ndaj Kartës së 24 janarit 1962 në lidhje me integrimin e mbështetjes logjistike për armët e avancuara në kohë lufte dhe paqeje [Referenca: C-M(62)2 dhe C-R(62)5];
- *Duke pasur parasysh* rregulloret për prodhimin dhe organizimet logjistike të NATO-s, miratuar më 17 maj 1962 [Referenca: C-M(62)18 dhe C-R(62)26];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 4 dhjetor 1963 në lidhje me integrimin e mbështetjes logjistike për armët e avancuara në kohë lufte dhe paqeje dhe me organizimin e NAMSO-s [Referenca: C-M(63)121 dhe C-R(63)71];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 4 nëntor 1964 për miratimin e Kartës së rishikuar të NAMSO [Referenca: C-M(64)77 dhe C-R(64)48], ndryshuar nga vendimi i marrë më 11 korrik 1986 në lidhje me rolin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë [Referenca: Korrigjimi i datës 10 nëntor 1986 ndaj shtojcës II të C-M(64)77];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 18 mars 1968 në lidhje me nenet 4 dhe 5 (misioni i NAMSO-s dhe funksionet e Agjencisë) të Kartës së NAMSO-s [Referenca: RDC/68/80 dhe PO/68/145];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 6 tetor 1972 që ndryshon Kartën e NAMSO-s për të pasqyruar një rishikim të një pjese të dokumentit të Këshillit të Atlantikut të Veriut mbi Sigurinë [Referenca: C-M(72)44];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 9 prill 1976 që ndryshon Kartën e NAMSO-s për të mbuluar ushtrimin e autoritetit të bordit të drejtorëve gjatë një alarmi apo lufte të NATO-s [Referenca: PO/76/23];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 15 shtator 2000, i cili miraton një rishikim për të përditësuar Kartën e NAMSO-s, duke përfshirë ndër të tjera një deklaram më të përmblodhur të misionit, si edhe autoritetin e deleguar për bordin e drejtorëve të NAMSO-s që të përfundojë memorandume mirëkuptimi me shtetet që marrin pjesë në partneritetin për paqe (PfP) [Referenca: PO(2000)167];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 29 korrik 2005 që miraton një ndryshim ndaj Kartës së NAMSO-s në lidhje me shtimin e shtatë shteteve të reja anëtare të NAMSO-s, duke iu referuar dokumenteve të reja të NATO-s mbi politikën e sigurisë, si edhe dhënien e kontratave në mbështetje të nismave të Politikës së Fondit të Besimit në shtetet joanëtare të NATO-s [Referenca: PO(2005)0066];
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 4 gusht 2006 që miraton një shtesë ndaj Kartës së NAMSO-s për të përfshirë autoritetin e deleguar për bordin e drejtorëve të NAMSO-s, që të përfundojnë memorandume mirëkuptimi me tekste standarde me shtetet që marrin pjesë në Dialogun Mesdhetar [Referenca: PO(2006)0077].
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës 28 shtator 2007 që miraton një shtesë ndaj Kartës së NAMSO-s në lidhje me shtimin e Islandës si shtet anëtar, duke filluar nga data 1 qershor 2007 [Referenca: PO(2007)0083].
- *Duke pasur parasysh* vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të datës \_\_\_\_\_, që miraton shtesën ndaj Kartës së NAMSO-s në lidhje me shtimin e Kroacisë si shtet anëtar, duke filluar që nga data 1 korrik 2009 [Referenca: PO(2009)0145].

**BORDI I DREJTORËVE TË NAMSO**  
**DATAT E HYRJES NË ORGANIZATËN E NATOS PËR MIRËMBAJTJEN DHE FURNIZIMIN**

Danimarka, Franca, Republika Federale e Gjermanisë, Greqia, Italia, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara	Maj 1958
Luksemburg	Tetor 1958
Belgjika	Janar 1959
Kanada	Janar 1975
Spanja	Janar 1985
Republika Çeke, Hungaria	Qershor 1999
Polonia	Dhjetor 1999
Sllovenia	Korrik 2004
Lituania	Gusht 2004
Sllovakia	Tetor 2004
Bullgaria, Estonia, Letonia, Rumania	Janar 2005
Islanda	Qershor 2007
Kroacia	Korrik 2009

**SEKSIONI I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**1. Përkufizim**

Organizata e NATO-s për Mirëmbajtjen dhe Furnizimin (në vijim quajtur “NAMSO”) është një organ i varur:

a) i krijuar brenda kuadrit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) për vënien në jetë të detyrave që dalin nga ky traktat e i ngritur nga Këshilli i Atlantikut të Veriut në pajtim me nenin 9 të Traktatit të Atlantikut të Veriut e në përputhje me marrëveshjen mbi statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, përfaqësuesve kombëtarë dhe personelit ndërkombëtar, të nënshkruar në Otava më 20 shtator 1951;

b) të cilit Këshilli i Atlantikut të Veriut i jep brenda kuadrit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, pavarësinë organizative, administrative dhe financiare të përcaktuar në vijim; dhe

c) i ngritur me synimin e plotësimin sa më mirë që të jetë e mundur të kërkesave kolektive të Belgjikës, Bullgarisë, Kanadasë, Kroacisë, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Francës, Republikës Federale të Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Islandës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Luksemburgut, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovakisë, Sllovenisë,

Spanjës, Turqisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, në fushën e logjistikës, sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 2 në vijim.

2. Procedurat e ndryshimit apo shpërbërjes

a) Vetëm Këshilli i Atlantikut të Veriut mund të shpërbëjë NAMSO-n, apo të ndryshojë ose shfuqizojë këtë kartë.

b) Kërkesat për këto veprime, normalisht, do t'i paraqiten bashkërisht nga shtetet e interesuara Këshillit të Atlantikut të Veriut përmes Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s.

## SEKSIONI II MISIONI

3. Misioni

a) Misioni i NAMSO-s është që të sigurojë mbështetje logjistike për NATO-n ose për shtetet e saj anëtare, individualisht ose kolektivisht.

b) Qëllimi i këtij misioni është që të maksimizojë qoftë në kohë paqeje, qoftë në kohë krizash dhe lufte, efikasitetin e mbështetjes logjistike të forcave të armatosura të shteteve të NATO-s dhe të minimizojë kostot.

4. Vlerësimet bazë

a) Me qëllim që të bëhet një përdorim sa më i mirë i burimeve dhe të mbështetet mbrojtja e përbashkët, shtetet e konsiderojnë atë të dëshirueshme që të zgjidhin bashkërisht problemet logjistike të mirëmbajtjes së pajisjeve ushtarake në kushte operacionale.

b) Meqë Këshilli i Atlantikut të Veriut ka njohur përgjegjësinë kolektive ndërmjet NATO-s dhe autoriteteve kombëtare për mbështetje logjistike në kuadrin e operacioneve shumëkombëshe, NAMSO-ja mund të japë mbështetje logjistike për shtetet e saj anëtare dhe për grupe të përbëra nga disa ose të gjitha ato shtete.

c) Për të arritur synimin e ruajtjes së efikasitetit të forcave ushtarake me kosto sa më të ulët, NAMSO-ja normalisht do të operojë përmes përdorimit të Agjencisë së NATO-s për mirëmbajtjen dhe furnizimin (në vijim quajtur si "Agjencia"), që punon në një kontroll shumëkombësh të ushtruar nga bordi i drejtorëve.

d) Agjencia do të kryejë ato funksione menaxhimi, të cilat mund të kryhen bashkërisht më me efikasitet sesa po të kryheshin individualisht nga shtetet anëtare. Ndër të tjera, kjo do të përfshijë blerjet e përbashkëta, furnizimin e përbashkët, si edhe veprimtaritë e përbashkëta për mirëmbajtje dhe riparime.

e) Për secilin nga shërbimet e kërkuara dhe, me qëllim që të maksimizohet efikasiteti i Agjencisë, shtetet e interesuara do të bëjnë përpjekje për të vendosur programe të përbashkëta kurdoherë që është e mundshme.

5. Funksionet e Agjencisë

a) Me qëllim që të përmbushë misionin e përcaktuar në nenin 3 më lart dhe në pajtim me dispozitat e seksionit VII më poshtë (organizimi dhe operimi), funksionet që i janë besuar Agjencisë mund të përfshijnë, në varësi të miratimit nga bordi i drejtorëve:

i) Administrimi i furnizimit

Për të mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi burimet e pjesëve të këmbimit dhe konsumimin e tyre; për të llogaritur kërkesat për të ardhmen, përfshirë këtu "kërkesat e në vijimësi"; për të përzgjedhur dhe menaxhuar magazinimin e atyre artikujve që janë me kosto shumë të lartë dhe që kërkohen aq rrallë sa magazinimi individual në shtetet e veçanta është joekonomik; si edhe për të arritur një rishpërndarje efikase të burimeve të pabalancuara.

ii) Administrimi i mirëmbajtjes

Për të mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi grumbullimin e materialeve të riparueshme; për të llogaritur kërkesat e ardhshme të mirëmbajtjes dhe riparimeve tërësore, duke përfshirë këtu ato "në vijimësi", siç përmendet më lart; për të përcaktuar dhe për të vendosur masa për riparime, mirëmbajtje dhe riparime tërësore me përfitim të përbashkët.

iii) Prokurimet

Për të mbajtur njohuri të vazhdueshme mbi burimet e prokurimeve; për të llogaritur kërkesat për prokurime të përbashkëta; për të llogaritur vëllimet ekonomike të prodhimit; dhe për të përmbushur apo kryer veprime të përshtatshme prokurimi. Ndërsa synimi kryesor i Agjencisë do të jetë që të përftojë çmimet më të favorshme për mallrat dhe shërbimet, ajo do të kryejë edhe planifikimin, sipas udhëzimeve të bordit të drejtorëve, për shpërndarjen e prodhimit të balancuar ndërmjet shteteve në masën më të madhe të zbatueshme.

iv) Asistenca teknike

Për të rregulluar shkëmbimin e informacionit teknik ndërmjet shteteve; për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të kodifikimit dhe identifikimit; për të siguruar që operimi i sistemeve logjistike kombëtare dhe i NAMSO-s të jenë në përputhje me njëri-tjetrin në masën maksimale; për të dhënë trajnime mbi logjistikën sipas kërkesës; për të lehtësuar ndërlicencimin ndërmjet shteteve; si edhe për të siguruar dhënien e këshillimeve ose udhëzimeve, si të jetë e përshtatshme, mbi shërbimet e kualifikimit dhe të kontrollit të cilësisë.

b) Funkcionet e përshkruara në nënparagrafët nga (i) deri në (iv) të këtij neni mund të zgjerohen me anë të një vendimi të posaçëm të bordit të drejtorëve, me qëllim që të mbulojnë funksionet e veçanta në administrimin, ndër të tjera, çmilitarizimin e sistemeve të armëve/armëve/municioneve ose për të rregulluar mundësinë që Agjencia të ruajë një masë dhe gamë më të madhe artikujsh sesa normalisht. Kjo shtrirje e funksioneve do të kufizohet në rastin në fjalë.

c) Funksione të tjera të nevojshme për të kryer funksionin e NAMSO-s të parashikuar në nenin 3 mund t'i besohen Agjencisë me një vendim të posaçëm të bordit të drejtorëve.

6. Përdorueshmëria e shërbimeve të dhëna nga Agjencia

a) Cilido shtet anëtar i NAMSO-s, për sa u përket të drejtave që ka, mund të përdorë tërësisht apo pjesërisht, shërbimet e dhëna nga Agjencia që renditen në nenin 5 më lart; por porositë e lidhura me këto shërbime do të kryhen vetëm, në mënyrën që dëshiron shteti i interesuar në përputhje me procedurat ekzistuese.

b) Cilado organizatë e krijuar sipas nenit 9 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, nëse ajo kështu dëshiron, mund të përdorë shërbimet e dhëna nga Agjencia sipas kushteve të rëna dakord bashkërisht ndërmjet bordit të drejtorëve dhe organizatës së interesuar.

c) Në kryerjen e misionit të përcaktuar në këtë seksion, shërbimet e Agjencisë do të kenë si qëllim forcat e armatosura të shteteve anëtare të NATO-s, përveç rasteve të autorizuara në mënyrë të posaçme nga Këshilli i Atlantikut të Veriut ku forcat e këtij të fundit ruajnë diskrecionin, në lidhje me marrësin përfundimtar, me kusht që të drejtat e pronësisë dhe industria e shteteve anëtare të respektohet. Shërbimet e dhëna nga shtetet anëtare në drejtim të palëve të treta nuk do të nënkuptojnë asnjë zotim ose përfshirje të asnjë lloji mënyre nga ana e NAMSO-s kundrejt këtyre palëve të treta pa pëlqimin e vet.

d) Një shtet që merr pjesë në Partneritetin për Paqe (PfP), i cili ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me NAMSO-s, të parashikuar nga neni 11 (c)(i) më poshtë, do të ketë mundësi hyrje në shërbimet e Agjencisë në fushat e përcaktuara sipas termave dhe kushteve të marrëveshjeve të posaçme me shkrim, të tilla si marrëveshje shitje, marrëveshje për sigurimin e shërbimeve, apo marrëveshje për partneritetin mbi sistemet e armëve të miratuara nga bordi i drejtorëve.

### SEKSIONI III STATUSI LIGJOR

7. Personaliteti juridik - zotësia

a) NAMSO-ja do të përbëjë një pjesë integrale të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

b) Ajo do të jetë pjesë dhe do të ndajë personalitetin ndërkombëtar të NATO-s, si edhe personalitetin juridik që zotërohet nga NATO-ja bazuar në nenin 4 Marrëveshjes së Otavës. Personaliteti juridik i NAMSO-s do të ndërthuret me atë të NATO-s dhe nuk mund të ndahet apo të jetë i dallueshëm prej tij.

#### 8. Privilegjet dhe imunitetet

Në bazë të përcaktimeve të parashikuara në nenin 1 (a) dhe 1 (c) të Marrëveshjes së Otavës, të gjitha dispozitat e zbatueshme të asaj Marrëveshje do të zbatohen efektivisht edhe ndaj NAMSO-s, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 9 më poshtë.

#### 9. Ushtrimi i të drejtave

a) Ushtrimi nga ana e NAMSO-s i atyre të drejtave dhe privilegjeve, të cilat ajo do t'i gëzojë në përputhje me nenet 7 dhe 8 më lart, do të kryhet brenda kufijve dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara me hollësi në këtë kartë, duke mbajtur parasysh rregullimet e bëra në nënparagrafin (b) më poshtë.

b) Rregullimet do të kryhen ndërmjet shtetit anëtar, në territorin e të cilit është ngritur NAMSO-s dhe shteteve të tjera të interesuara, me qëllim që të përcaktohet me hollësi, duke mbajtur parasysh nenin 3 të Marrëveshjes së Otavës, mënyrën e vënies në jetë të dispozitave të asaj Marrëveshje. Rregullime të tilla do të përfshijnë çfarëdo dispozitash të përshtatshme administrative, veçanërisht në lidhje me doganat dhe çështjet fiskale, në lidhje me nenet 9 dhe 10 të Marrëveshjes së Otavës. Këto rregullime do të arrihen me qëllimin e lehtësimit të veprimtarive të NAMSO-s dhe të shmangies së dëmeve ndaj ekonomisë së shteteve anëtare.

### SEKSIONI IV MARRËVESHJET DHE KONTRATAT

10. Në kryerjen e misionit të saj dhe brenda qëllimit të këtij misioni, siç përcaktohet në seksionin II më lart, NAMSO-ja:

a) mund të lidhë marrëveshje dhe kontrata, si edhe të përftojë dhe shesë pasuri në emër të NATO-s;

b) mund të lidhë marrëveshje administrative me organe të tjera të NATO-s.

11. Sidoqoftë, do të duhet të jepet miratimi paraprak nga Këshilli i Atlantikut të Veriut përpara sesa NAMSO-ja të lidhë:

a) çfarëdo marrëveshje apo kontratë që përfshin:

i) një qeveri të një vendi që nuk është anëtar i NATO-s; ose

ii) një organizatë ndërkombëtare (për qëllimet e kësaj karte, një organ i ngritur në përputhje me nenin 9 të Traktatit të Atlantikut të Veriut nuk është një organizatë ndërkombëtare);

b) çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare që kërkon miratimin e parlamentit të një shteti anëtar;

c) me delegim nga Këshilli i Atlantikut të Veriut.

i) Bordi i drejtorëve të NAMSO-s autorizohet që të arrijë memorandume mirëkuptimi mbi bashkëpunimin në fushën e mbështetjes logjistike, në varësi të autorizimit paraprak nga Zyra e Sigurisë së NATO-s, me shtetet që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe<sup>1</sup>;

ii) Bordi i drejtorëve të NAMSO-s, pa delegim të mëtejshëm të autoritetit miratues ndaj cilitdo organ tjetër, autorizohet që të lidhë marrëveshje me vendet e Dialogut Mesdhetar (MD) mbi blerjen e materialeve të mbrojtjes që nuk janë të disponueshme në shtetet e NATO-s për kërkesat urgjente operationale të vendeve blerëse të saj, si edhe mbi veprimtari mbështetëse logjistike bashkëpunuese që lidhen me projektet e Fondit të Besimit ku NAMSA-ja është zgjedhur si agjent ekzekutiv, në përputhje me politikën dhe përcaktimet e NAC<sup>2</sup>;

<sup>1</sup> PO (INV) (98) 34.

<sup>2</sup> SG (2006) 0222; C – M (2006) 0091.

iii) NAMSA-ja mund të japë kontrata drejt vendeve që nuk janë anëtare të NATO-s për ato nisma sipas politikës së fondit të besimit të NATO/PfP, për të cilat NAMSA-ja është agjenti ekzekutiv<sup>3</sup>.

12. Autoriteti i NAMSO-s, siç përcaktohet në nenin 10 më lart, do të ushtrohet duke mbajtur parasysh në mënyrën e duhur kërkesat e nenit 11 më lart, ose nga bordi i drejtorëve ose nga administratori i përgjithshëm, siç përcaktohet me hollësi në nenin 37 (d) më poshtë.

13. Dispozitat e neneve 11 dhe 12 më lart nuk do ta pengojnë bordin e drejtorëve që të delegojë në drejtim të një individi kryerjen e aktit ekzekutiv të nënshkrimit të një marrëveshje të miratuar në mënyrën e duhur.

## SEKSIONI V PRONËSIA E PASURIVE

14. Dispozita të përgjithshme

a) Në zbatim të nenit 7 më lart, të gjitha pasuritë e përfuara nga NAMSO-ja ose, pas një vendimi të posaçëm të bordit të drejtorëve, nga një shtet anëtar i NAMSO-s në emër të NAMSO-s dhe përmes financimit të përbashkët, do të përftohet në emër të dhe si pronësi e NATO-s.

b) Sidoqoftë, të gjitha të drejtat që gëzon NATO-ja në përputhje me nënparagrafin (a) më lart do të ushtrohen nga NAMSO-ja ose, pas delegimit të posaçëm nga NAMSO-ja, nga një shtet anëtar i përcaktuar posaçërisht.

c) Duke qenë se misioni kryesor i NAMSO-s është që të shesë sërish një pjesë të pasurive të saj drejt shteteve anëtare, kushtet e shitjes duhet të përcaktohen në direktivat e miratuara nga bordi i drejtorëve.

15. Pasuritë e përfuara nga buxheti administrativ i Agjencisë

Alokimi i çdo të ardhure që rrjedh nga shitja e pasurive të përfuara nga NAMSO-ja, në përputhje me buxhetin administrative të Agjencisë, do të vendoset nga bordi i drejtorëve. Në rastin e shkrirjes së NAMSO-s, diferenca ndërmjet fitimeve të realizuara nga shitja e këtyre pasurive dhe shpenzimeve të ndërmarra nga NAMSO-ja do të ndahet ose do të përballohet nga shtetet anëtare të NAMSO-s në përputhje me një formulë që do të përcaktohet paraprakisht nga bordi i drejtorëve.

16. Pasuritë e përfuara nga fonde të tjera

Kurdoherë që pasuritë do të përftohen në emër të një partneriteti për sistemet e armëve (duke iu referuar neneve nga 33 deri në 35 më poshtë), ose nga një grup shtetesh, shtetet e interesuara do të vendosin masa të posaçme financiare dhe do të përcaktojnë me hollësi, në përputhje me këtë Kartë, metodat e financimit, menaxhimit, shitjes dhe transferimit.

## SEKSIONI VI PËRGJEGJËSIA

17. Përgjegjësia për veprimtaritë e NAMSO-s, duke përfshirë këtu çfarëdo marrëveshje apo kontratë, të lidhur në përputhje me seksionin IV më lart, do të mbahet nga NATO-ja. Sidoqoftë, brenda NATO-s, shtetet anëtare të NAMSO-s do të marrin përsipër bashkërisht këtë përgjegjësi përballë NATO-s dhe do të përballojnë çfarëdolloj kostoje që rrjedh, ose në përputhje me një formulë që do të përcaktohet me hollësi nga bordi i drejtorëve, ose në rastin e partneriteteve të sistemeve të armëve, sipas kushteve në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet nga 33 deri në 35 më poshtë.

18. Kurdoherë që provohet se është e nevojshme që të futet një dispozitë arbitrazhi në një kontratë të lidhur nga NAMSO-ja me një shoqëri, me qëllim që të lejohet NAMSO-ja që të kryejë me përpikëri misionin që i është besuar në këtë kartë, kjo dispozitë do të nxirret në mënyrë të detyrueshme, siç është përcaktuar në shtojcën II të kësaj karte.

<sup>3</sup> PO (2002) 181, shtojca I, paragrafi 6 (d); PO (2005) 0066.



19. Këshilli i Atlantikut të Veriut do të parashikojë, në përputhje me nenin 24 të Marrëveshjes së Otavës, mënyrat e duhura të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të natyrës private, me origjinë të ndryshme nga ajo kontraktore.

## SEKSIONI VII ORGANIZIMI DHE OPERIMI

### Nëseksioni A Të përgjithshme

20. NAMSQ-ja do të përfshijë:

a) një bord të drejtorëve, të përbërë nga një përfaqësues nga secili shtet që është anëtar i NAMSQ; secili shtet do të ketë të drejtën për një votë; dhe

b) një organ ekzekutiv, i referuar si "Agjencia", të përbërë nga një administrator i përgjithshëm dhe organizmi nën komandën e tij.

21. Bordi i drejtorëve mund të ngrejë qendra apo magazina, me qëllim që të mundësojë NAMSQ-n për të kryer misionin e vet. Statusi i këtyre qendrave operacionale apo magazinave do të përcaktohet me hollësi nga bordi i drejtorëve rast pas rasti.

22. Një shtet anëtar i NATO-s, por që nuk është anëtar i NAMSQ-s mund të bëhet anëtar i kësaj të fundit me votën unanime të shteteve ekzistuese anëtare të NAMSQ-s në kohën e aplikimit për anëtarësi. Hyrja e një tjetër shteti anëtar do t'i nënshtrohet kushteve të hyrjes në përputhje me këtë Kartë, siç do të bien dakord shtetet anëtare të NAMSQ-s, ekzistuese në atë kohë dhe shteti i ardhshëm anëtar.

23. Në rastin kur një shtet anëtar zgjedh të tërhiqet nga anëtarësia në NAMSQ-s, tërheqja e atij shteti do t'i nënshtrohet atyre kushteve, në përputhje me këtë kartë, siç do të bien dakord shtetet anëtare që mbeten në NAMSQ dhe shteti që tërhiqet.

24. Një qeveri mund të komunikojë me NAMSQ-n ose përmes delegacionit të vet kombëtar në NATO, ose përmes përfaqësuesit të saj në bordin e drejtorëve, i cili do të mbajë të informuar delegacionin e tij kombëtar mbi veprimtaritë e atij bordi të drejtorëve. Kopje të të gjitha dokumenteve të dërguara nga NAMSQ-ja në drejtim të përfaqësuesit të një shteti anëtar në bordin e drejtorëve do t'i dërgohen gjithashtu, delegacionit të këtij shteti anëtar në NATO.

25. a) Bordi i drejtorëve do të ftojë autoritetet ushtarake të NATO-s që të emërojnë një përfaqësues, i cili mund të ndjekë të gjitha takimet e bordit të drejtorëve si këshilltar dhe si oficer ndërlidhës. Marrëdhënia ndërmjet NAMSQ-s dhe autoriteteve ushtarake të duhura të NATO-s në kohë krizash ose lufte do të mbahet në përputhje me vendimet e marra nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, të zbatueshme ndaj statusit në kohë lufte të NPLO<sup>4</sup>.

b) Duke pasur parasysh vendimin e marrë nga Këshilli i Atlantikut të Veriut më 24 janar 1962, në lidhje me integrimin e mbështetjes logjistike për armët e avancuara në kohë lufte dhe paqeje, bordi i drejtorëve do të ndërmarrë hapa për të vënë në jetë ato dispozita që prekin NAMSQ-n dhe që përmbahen në shtojcën I të kësaj karte.

c) Direktiva të posaçme do të nxirren nga bordi i drejtorëve dhe do t'i paraqiten për miratim Këshillit të Atlantikut të Veriut, në lidhje me masat në kohë paqeje për detyrat e NAMSQ-s në kohë lufte, veçanërisht për ndryshimin e operacioneve nga operacione në kohë paqeje në operacione në kohë lufte. Këto masa do të përfshijnë edhe procedurat në lidhje me zhvillimin e kërkesave dhe përparësive për të krijuar një gjendje logjistike, e cila e pajis Aleancën në mënyrën më të mirë për t'iu përgjigjur me efikasitet emergjencave.

---

<sup>4</sup> NPLO i referohet organizmave të NATO-s për prodhimin dhe logjistikën.

Nënseksioni B  
**Bordi i drejtorëve**

26. Anëtarësia

a) Secili shtet do t'i komunikojë përmes kanaleve zyrtare Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe kryetarit të bordit të drejtorëve emrat e përfaqësuesit të tij dhe të cilitdo përfaqësues alternativ në bordin e drejtorëve. Ai do të japë në kohën e duhur udhëzime për përfaqësuesin e tij në atë bord të drejtorëve.

b) Secili përfaqësues në bordin e drejtorëve mund të ndihmohet nga ekspertë vendas, të cilët mund të marrin pjesë në diskutime në takimet e bordit të drejtorëve.

c) Emërimi si një anëtar të personelit të agjencisë, i një personi, i cili ka shërbyer si përfaqësues në bordin e drejtorëve në çfarëdo periudhe gjatë tre viteve përpara emërimit, duhet të bëhet vetëm në rrethana përjashtimore dhe në çdo rast duhet të miratohet njëzëri nga bordi i drejtorëve.

27. Kryetari

a) Bordi i drejtorëve do të zgjedhë kryetarin e tij për një vit. Kryetari mund të rizgjidhet.

b) Kryetari nuk do të mbajë asnjë detyrë të përfaqësimit kombëtar dhe as të drejtë vote në bordin e drejtorëve.

c) Autoriteti i kryetarit është i prejardhur nga bordi i drejtorëve. Ai do të jetë përgjegjës përballë bordit të drejtorëve për të gjitha veprimet që ai mund të ndër marrë në përputhje me këtë kartë dhe vendimet e marra nga bordi i drejtorëve.

28. Organizimi

a) Bordi i drejtorëve do të përcaktojë organizimin e tij dhe rregullat e tij të brendshme në përputhje me këtë kartë. Ai mund të krijojë një sekretariat të përhershëm, ndaj të cilit do të zbatohen dispozitat e nenit 39 më poshtë.

b) Bordi i drejtorëve do të mbledhet rregullisht në intervale të tilla kohe që ta lejojnë atë të kryejë me efikasitet përgjegjësitë e veta dhe në mënyrën më të shpejtë të mundshme në përgjigje të një kërkesë të posaçme nga cilido shtet anëtar.

c) Bordi i drejtorëve, duke mbajtur parasysh në mënyrën e duhur nenet 24, 45 dhe 47 të kësaj karte, mund të kufizojë, si të jetë e përshtatshme, shpërndarjen e dokumenteve dhe materialeve që mbulojnë informacione të veçanta teknike dhe të drejta të pronësisë, ose çështje të tjera tregtare apo industriale të një natyre konfidenciale.

29. Komitetet

Bordi i drejtorëve mund të ngrejë, si të jetë e përshtatshme, komitete ekspertësh, duke përfshirë edhe përfaqësues të qeverive. Në çdo rast, ai do të ngrejë një komitet të financave. Këto komitete do të këshillojnë dhe ndihmojnë bordin e drejtorëve në kryerjen e detyrave të tij e do t'i paraqesin këtij të fundit rekomandimet e tyre, të cilat bordi i drejtorëve do t'i marrë në shqyrtim kur merr vendimet e veta.

30. Vendimet

a) Bordi i drejtorëve do t'i marrë vendimet e veta me shumicë të thjeshtë. Parimi i unanimitetit do të zbatohet sidoqoftë për të gjitha vendimet që kanë implikime financiare, në lidhje me çështje të politikës së përgjithshme apo në lidhje me miratimin e zgjedhjes së personelit në nivelin A-5 e më lart.

b) Cilido shtet anëtar që ka mendimin se një vendim i bordit të drejtorëve i marrë me shumicë votash nuk është në përputhje me interesat e tij ose se ky vendim mund të cenojë atë shtet, mund t'ia paraqesë këto çështje për zgjidhje Këshillit të Atlantikut të Veriut.

31. Autoriteti

a) Bordi i drejtorëve do të jetë përgjegjës vetëm për:

i) vendimet e politikave të përgjithshme, si edhe për nxjerrjen e udhëzimeve për të mundësuar NAMS0-n që të përmbushë misionin e saj;

ii) dhënien e drejtimeve për operimin dhe administrimin e Agjencisë;

iii) politikën që duhet ndjekur për lidhjen e kontratave për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve me firma që ndodhen në një shtet që nuk është anëtar i NATO-s. Si rrjedhim, çfarëdo kontrate me një firmë që ndodhet në një shtet që nuk është shtet anëtar i NATO-s duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e bordit të drejtorëve ose t'i nënshtrohet miratimit të shprehur të bordit të drejtorëve;

iv) organizimi i Agjencisë, përcaktimi i pozicioneve të punës dhe miratimi i përzgjedhjes së personelit të nivelit A-5 dhe më lart;

v) vendimet buxhetore dhe financiare;

vi) ushtrimin e kontrollit administrativ e drejtues përmes krahasimit të veprimtarive të Agjencisë me udhëzimet e zbatueshme të bordit të drejtorëve.

b) Bordi i drejtorëve mund t'i delegojë fuqitë e tij vendimmarrëse te komitetet e përhershme të referuara në nenin 29 më lart, duke përcaktuar edhe kufijtë e këtyre delegimeve.

32. Ushtrimi i autoritetit të bordit të drejtorëve gjatë një krize ose lufte

a) Në parim, gjatë një krize apo lufte do të mbeten të zbatueshme dispozitat e neneve 26-31.

b) Nëse gjatë një krize ose lufte nuk mund të thirret një takim i bordit të drejtorëve, autoriteti i bordit të drejtorëve do të ushtrohet nga administratori i përgjithshëm pas këshillimeve me kryetarin.

c) Vendimet e marra në kushtet e jashtëzakonshme të përcaktuara në nenin 32 (b) duhet të kenë natyrën e një emergjence absolute, duke mos lejuar asnjë mundësi që ato të ndryshojnë. Vlefshmëria e këtyre vendimeve, për aq sa është e mundur, do të jetë e përkohshme dhe do t'i nënshtrohet rishqyrtimit dhe ratifikimit nga bordi i drejtorëve për çfarëdo shtyrje të mundshme në të ardhmen, në momentin më të parë që një takim i bordit të drejtorëve mund të mbledhet.

d) Kryetari i bordit të drejtorëve është përgjegjës për të përcaktuar nëse ekzistojnë kushtet e nenit 32 (b) për një ushtrim të posaçëm të autoritetit të bordit të drejtorëve, si edhe kur ato pushojnë së ekzistuari. Ai është, gjithashtu, përgjegjës për të regjistruar të gjitha vendimet e marra në kushtet e nenit 32 (b) dhe për shpërndarjen e tyre ndaj shteteve anëtare në masën që është e mundur.

e) Gjatë një krize ose lufte, afati i qëndrimit të kryetarit në detyrë do të zgjatet e do të vazhdojë përtej kohëzgjatjes normale të tij (neni 27) deri në momentin që do të jetë e mundur të mbledhet një takim i bordit të drejtorëve.

f) Nëse kryetari nuk është i mundur për të përmbushur funksionet e tij, siç janë përcaktuar në këtë nen dhe në nenin 34, ato do të merren përsipër nga administratori i përgjithshëm.

#### Nënseksioni C

#### Partneritetet e NAMSO-s për sistemet e armëve

33. Partneritetet për sistemet e armëve mund të krijohen brenda NAMSO-s, duke iu nënshtuar termave dhe kushteve të sakta, mbi nismën e disa shteteve të caktuara që dëshirojnë të organizohen bashkërisht në mbështetjen logjistike të një arme të dhënë.

34. (a) Bordi i drejtorëve miraton:

i) ngritjen e një partneriteti për sistemet e armëve apo lidhjen e tij me NAMSO-n;

ii) çdo vendim të marrë në parim brenda një partneriteti të tillë; përpara se sa këto masa të vihen në jetë brenda NAMSO.

b) Duke iu referuar zbatimit të nenit 34 (a)(ii) më lart, miratimi i bordit të drejtorëve nuk do të jetë i nevojshëm kur mbizotërojnë kushtet e parashikuara në nenin 32 (b).

c) Partneriteti për sistemet e armëve do të informojë kryetarin e bordit të drejtorëve mbi të gjitha vendimet e tij të cilat normalisht do të kishin pasur nevojë për miratimin e bordit të drejtorëve. Kryetari do t'ia shpërndajë këto vendime të gjitha shteteve në masën që është e mundshme.

35. a) Partneritetet për sistemet e armëve përbëjnë një pjesë integrale të NAMSO-s dhe janë pjesë në personalitetin juridik që gëzon NAMSO-s sipas termave të nenit 7 më lart.

b) Sidoqoftë, një pjesë e dallueshme e pasurive të NAMSO-s do të jetë e rezervuar për mbështetjen e vetëm të një sistemi të dhënë armësh. Në kohën e krijimit të një partneriteti për

sistemet e armëve, shtetet pjesëmarrëse do të kenë vendosur masa të posaçme financiare, duke përcaktuar me hollësi:

- i) metodat për administrimin e kësaj pjese të pasurive;
- ii) të drejtat dhe detyrimet e secilit shtet pjesëmarrës;
- iii) termat financiarë dhe kushtet për shkrijen e partneritetit për sistemet e armëve ose për tërheqjen nga ai të disa prej anëtarëve të tij.

#### Nënseksioni D **Organi ekzekutiv (Agjencia)**

##### 36. Administratori i përgjithshëm - emërimi

Administratori i përgjithshëm do të emërohet nga bordi i drejtorëve pas këshillimeve me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s; kontrata e tij do të miratohet nga bordi i drejtorëve dhe do t'i paraqitet për nënshkrim Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s.

##### 37. Administratori i përgjithshëm - autoriteti

Në drejtimin e operacioneve të Agjencisë, administratori i përgjithshëm:

- a) do të vërë në jetë vendimet e bordit të drejtorëve dhe do të shndërojë politikën e vendosur nga bordi i drejtorëve në politikë veprimi;
- b) do të përgatisë plane për organizimin dhe operimin dhe t'ia paraqesë ato për miratim bordit të drejtorëve;
- c) do të përgatisë projektbuxhete dhe raporte financiare për bordin e drejtorëve, në përputhje me nenet 43 dhe 44 më poshtë;
- d) do të ushtrojë autoritetin kontraktor të deleguar ndaj tij nga bordi i drejtorëve. Sidoqoftë, bordi i drejtorëve:
  - i) nuk do t'i delegojë administratorit të përgjithshëm autoritetin e tij për të lidhur kontrata përtej kompetencës së marrëdhënieve të zakonshme të administrimit dhe punës, përveçse pas rishikimit të kujdesshëm, rast pas rasti;
  - ii) nuk do të autorizojë administratorin e përgjithshëm që të lidhë marrëveshje ndërkombëtare;
  - e) ndjekë të gjitha takimet e bordit të drejtorëve, përveçse kur vendoset ndryshe, në raste të posaçme, nga ai bord i drejtorëve; ai gjithsesi nuk do të ketë të drejtë vote në asnjë rast;
  - f) angazhojë personelin e nevojshëm për të plotësuar pozicionet brenda strukturës së miratuar dhe për t'i paraqitur në kohën e duhur përzgjedhjet e tij për pozicionet e nivelit A-5 bordit të drejtorëve për miratim.

##### 38. Administratori i përgjithshëm - përgjegjësia

Administratori i përgjithshëm do të jetë drejtpërdrejt përgjegjës përpara bordit të drejtorëve për operimin e agjencisë, edhe në rastet kur ai i ka deleguar një pjesë të autoritetit të tij personelit të vet. Si pasojë, administratori i përgjithshëm do t'i paraqesë bordit të drejtorëve raporte periodike mbi operimin e Agjencisë.

##### 39. Personeli

Agjencia do të përfshijë:

- a) Ato kategori të personelit, të cilat mbi bazën e një marrëveshje të lidhur në mënyrën e duhur në përputhje me nenin 17 të Marrëveshjes së Otavës ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe qeverive të interesuara, përbëjnë personelin ndërkombëtar të NATO-s. Në mungesë të një vendimi të shprehur të Këshillit të Atlantikut të Veriut për të kundërtën, ky personel do t'i nënshtrohet të njëjtave rregulla të personelit, si edhe anëtarët e sekretariatit ndërkombëtar të NATO-s me gradën korresponduese, duke përfshirë këtu ato dispozita që lidhen me sistemin e sigurimeve shoqërore dhe me fondin e rezervës. Bordi i drejtorëve do të sigurojë që numri i pozicioneve të përcaktuara me këto kategori të kufizohet vetëm tek ato që kërkojnë njëkohësisht privilegjet dhe imunitetet e bashkëngjitura për përmbushjen e tyre.

b) Ato kategori të personelit, të cilat nuk kanë status ndërkombëtar. Rregulloret që rregullojnë këtë personel do të parashikohen nga bordi i drejtorëve në këshillim me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s dhe në marrëveshje me shtetin pritës.

#### 40. Bashkëndimi i personelit

Agjencia do të përfaqësohet në një panel këshillimor të përcaktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s me synimin e këshillimit dhe bashkëndimit, me qëllim që të ndihmojë zyrën përkatëse të NATO-s për të ngritur dhe përditësuar rregulloret e NATO-s për personelin civil.

#### 41. Bashkëndimi administrativ

a) NAMSO-ja do t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s të gjithë informacionin dhe ndihmesën e nevojshme për vënien në jetë të nenit 37 (a) të rregulloreve të NPLO të C-M(62)18.

b) NAMSO-ja do të bëhet pjesë e këtyre rregullave dhe rregulloreve të standardizuara që do të miratohen dhe përcaktohen si të detyrueshme nga Këshilli i Atlantikut të Veriut.

c) Megjithatë, bordi i drejtorëve nuk do t'i shmanget në mënyrë të panevojshme atyre rregullave dhe rregulloreve të standardizuara që nuk janë përcaktuar si të detyrueshme nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, si edhe rregullave dhe rregulloreve të tjera ndërkombëtare të personelit që janë shpallur në mënyrën e duhur.

### Nënseksioni E

#### **Administrimi financiar**

#### 42. Dispozita të përgjithshme

a) Administrimi financiar i NAMSO-s do të jetë i ndarë dhe i dalluar nga ai i personelit ndërkombëtar, nga ai i organizatave të tjera të NATO-s për prodhimin dhe logjistikën apo nga ai i organeve të tjera të NATO-s.

b) Kostoja e veprimtarive të NAMSO-s, për mbulimin si të funksioneve të saj administrative ashtu edhe të atyre operacionale, do të përballohet nga shtetet anëtare të NAMSO-s dhe mundësisht nga organet e NATO-s ose, kur miratohet nga BOD, nga qeveritë e shteteve që nuk janë anëtare të NATO-s ose nga organizatat ndërkombëtare që përdorin shërbimet e saj.

c) Në lidhje me kostot administrative, NAMSO-ja do të vetëfinancohet, kryesisht me anë të tarifave shtesë të përfshira në çmimet e pjesëve të këmbimit dhe të shërbimeve të ofruara nga Agjencia, ose mundësisht me çfarëdo mjetesh të tjera të përshtatshme. Hollësitë e financimeve do të përcaktohen nga bordi i drejtorëve dhe nëse është e nevojshme do të jenë në formën e udhëzimeve.

d) Në lidhje me kostot operacionale, financimi i tyre do të mbulohet në përputhje me udhëzimet e bordit të drejtorëve, duke mbajtur parasysh në mënyrën e duhur, si të jetë e nevojshme, rregullimet financiare të referuara në nenin 35 (b) më lart. Për secilin nga programet e NAMSO-s, të ardhurat operacionale dhe shpenzimet, përfshirë këtu investimet, duhet të jenë të ekuilibruara.

e) NAMSO-ja do të miratojë një grup rregullash financiare që mbulojnë si anën administrative ashtu edhe veprimtaritë operacionale, në pajtim me këtë nen dhe me cilëndo rregullore të shpallur në përputhje me nenin 41 më lart.

f) Të gjitha fondet e NAMSO-s, konkretisht:

i) të ardhurat e krijuara nga veprimtaritë e autorizuara të Agjencisë;

ii) fondet që i janë vënë në dispozicion Agjencisë nga anëtarët e saj në mënyra të tjera;

do të inventarizohen në buxhetin administrativ ose operacional të Agjencisë dhe në deklaratat financiare vjetore.

#### 43. Buxheti

a) Qëllimi i programit dhe planet operuese të Agjencisë, të cilat në asnjë lloj mënyre nuk përdorin financat kombëtare, do të pasqyrohen në dy buxhete vjetore:

i) një buxhet administrativ që mbulon të gjitha shpenzimet që duhen bërë për funksionimin e brendshëm të Agjencisë dhe Sekretariatit, siç tregohet në nenin 28 (a); dhe

ii) një buxhet operacional, që tregon planet financiare të bëra për të mbuluar shpenzimet e inventarit, blerjeve dhe mirëmbajtjes.

Këto dy buxhete do të tregojnë kostot rrjedhëse, si edhe kostot jorrrjedhëse (kapitale).

b) Buxhetet e Agjencisë do të përcaktojnë me hollësi:

i) kufirin maksimal të shpenzimeve të autorizuara;

ii) vlerësimin e shpenzimeve që nuk i nënshtrohen rregullit të kufirit maksimal;

iii) burimet nga të cilat do të financohen këto shpenzime.

Bordi i drejtorëve do të sigurojë që detyrimet financiare të parashikuara në buxhete të mos tejkalojnë fondet e parashikuara në nenin 42 (d) më lart.

c) Projektbuxhetet do të përgatiten nga administratori i përgjithshëm dhe do t'i paraqiten nga vetë ai bordit të drejtorëve për miratim, në datën dhe të shoqëruar me shpjegimet, siç do të udhëzohet nga bordi i drejtorëve. Administratori i përgjithshëm do t'i përcjellë, gjithashtu, një kopje komitetit të financave, i cili do t'i rishikojë ato dhe do të bëjë rekomandimet e tij për bordin e drejtorëve.

d) Administratori i përgjithshëm do të veprojë në pajtim me buxhetin. Ai nuk do ta përfshijë NAMSOn përtej fondeve të përmendura në buxhete, dhe as do ta përfshijë NAMSOn duke lidhur kontrata, financimi i të cilave do të kërkonte kontribute të posaçme nga shtetet anëtare të NAMSOS.

e) Çfarëdo autoriteti për të lidhur kontrata ose për të ndërmarrë detyrime financiare, shpenzime për të cilat kërkohen fonde nga buxhetet e ardhshme, do të citohet veçmas në buxhete.

#### 44. Deklaratat financiare

a) Administratori i përgjithshëm do të paraqesë pasqyra vjetore të bilancit, deklarata për humbjet dhe fitimet dhe llogaritë e hollësishme që tregojnë shpenzimet dhe të ardhurat aktuale në termat e artikujve që përmbahen si në buxhetin administrativ ashtu edhe në atë operacional.

b) Përveç këtyre deklaratave vjetore, deklarime të tjera periodike do t'i paraqiten nga ana e Agjencisë, siç do të udhëzohet nga bordi i drejtorëve.

c) Bordi i drejtorëve do të miratojë deklaratat vjetore financiare të administratorit të përgjithshëm, vetëm pasi ka marrë parasysh raportin e bordit ndërkombëtar të auditorëve për NATO-n, të përmendur në nenin 51 dhe komentet e komitetit të financës si mbi deklaratat ashtu edhe mbi raportin.

## Nëseksioni F

### Siguria

45. a) NAMSOn do t'i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të sigurisë të përcaktuara në politikën e NATO-s mbi sigurinë (C-M(2002)49, C-M(2002)50 dhe direktivave mbështetëse, si edhe të gjitha ndryshimeve të tyre, dhe atyre rregulloreve të tjera mbi sigurinë të miratuara nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, siç mund të jenë ato të zbatueshme;

b) NAMSOn:

i) do të hartojë rregulloret zbatuese të sigurisë për Agjencinë në përputhje me dispozitat e politikës së NATO-s mbi sigurinë dhe me direktivat mbështetëse dhe do të mbikëqyrë zbatimin e tyre;

ii) në bashkëpunim me NSA/DSA<sup>5</sup> të interesuar dhe zyrën e sigurisë së NATO-s, do të bashkërendojë vënien në jetë të politikave dhe të direktivave të NATO-s për sigurinë, përmes kontraktorëve dhe kontraktorëve të mundshëm, si edhe të merret me çfarëdo problemi të sigurisë që lind në cilindo projekt të NATO-s, në të cilin është e përfshirë Agjencia;

iii) do të ndërmarrë veprime si t'i kërkohet dhe në përputhje me dispozitat e politikës së NATO-s mbi sigurinë dhe ato të direktivës së Komitetit të Sigurisë së NATO-s mbi sigurinë industriale<sup>6</sup>, në lidhje me rregullimet e posaçme për vizitat ndërkombëtare; dhe

iv) do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e udhëzimeve të sigurisë së projektit (PSI) për programet që NAMSOn administron për miratim nga NSA/DSA pjesëmarrëse.

<sup>5</sup> Autoritetet kombëtare të sigurisë /autoritetet e caktuara për sigurinë

<sup>6</sup> AC/35-D/2003, 17 qershor 2002 (Ekstrakt në shtojcën IV të kartës)

Nënseksioni G  
**Bashkërendimi dhe kontrolli**

46. NAMSO-ja do të vendoset nën autoritetin e Këshillit të Atlantikut të Veriut. Ky i fundit mund që në çdo kohë të ngrejë çfarëdo çështje në lidhje me organizimin ose operimin e saj.

47. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s do të caktojë si oficer ndërlidhës në NAMSO një pjesëtar të personelit të tij, i cili do të ketë të drejtë të ndjekë të gjitha takimet e bordit të drejtorëve. Ky oficer nuk do të ketë të drejtë vote. Ndër të tjera, ai do të japë këshilla dhe rekomandime në lidhje me procedurat dhe praktikat administrative të NATO-s. Oficeri i caktuar ndërlidhës do të ketë mundësi hyrje në të gjitha dokumentet e NAMSO-s dhe do t'i sigurojë organizatës ato dokumente të NATO-s që janë me interes për të dhe për dokumentet e klasifikuara, mbi bazën e "nevojës për të njohur" dhe me miratimin paraprak të autorit.

48. Ky oficer ndërlidhës mund të ngrejë në mënyrë verbale apo me shkrim çfarëdo çështje që ai vlerëson të përshtatshme.

49. Nëse Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerëson se cilido vendim i bordit të drejtorëve, që i është komunikuar nga oficeri i tij ndërlidhës, është në kundërshtim me dispozitat e kësaj karte apo e një natyre që vë në rrezik interesat e përgjithshme të NATO-s, ai do të informojë për këtë bordin e drejtorëve dhe nëse është e nevojshme, do të njoftojë për këtë çështje Këshillin e Atlantikut të Veriut për një veprim të tillë që ai dëshiron të ndërmarrë.

50. Çdo vit, bordi i drejtorëve do të paraqesë për shqyrtim përpara Këshillit të Atlantikut të Veriut një raport mbi veprimtaritë e vitit të kaluar dhe një parashikim të veprimtarive për vitin që vjen.

51. Bordi ndërkombëtar i auditorëve për NATO-n do të kontrollojë nga ana financiare llogaritë e Agjencisë sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën III të kësaj Karte.

**SHTOJCA I**

**DISPOZITA PËR MBËSHTETJEN LOGJISTIKE PËR ARMËT E AVANCUARA QË I JANË  
CAKTUAR SACEUR, QË RRJEDHIN NGA ZBATIMI I DOKUMENTIT MC 86/2(I  
RISHIKUAR) (VENDIMI PËRFUNDIMTAR) DHE KORRIGJIMI 1**

1. Administrimi nga ana e NAMSO-s i mbështetjes logjistike për armët e avancuara që i janë caktuar SACEUR, megjithëse është brenda kuadrit të përgjithshëm të dispozitave të kësaj karte, duhet gjithsesi t'u nënshtrohet dispozitave shtesë të përcaktuara më poshtë.

2. Në përputhje me parimet e parashtruara në dokumentet MC 86/2 (i rishikuar) (vendimi përfundimtar) dhe korrigjimin 1 si edhe MC 53/2 (i rishikuar) (përfundimtar), kjo shtojcë ka për qëllim të përcaktojë për secilën sistem të përzgjedhur armësh të avancuara një procedurë, e cila do t'i lejojë SACEUR dhe NAMSO që të marrin përsipër përgjegjësitë e përcaktuara me hollësi më poshtë dhe agjencinë që të sigurojë mbështetjen logjistike të kërkuar ndaj saj nga shtetet anëtare.

3. Për mbështetjen logjistike të armëve të avancuara të zgjedhura, SACEUR, në kohë paqeje, do të emërojë në bordin e drejtorëve, si këshilltarin e tyre ushtarak, një përfaqësues, i cili do të paraqesë këshilla dhe rekomandime për bordin e drejtorëve në përputhje me 53/2 (i rishikuar) (përfundimtar) mbi:

a) përzgjedhjen e armëve të avancuara, për të cilat ndihma logjistike duhet të sigurohet nga Agjencia;

b) niveli i stokut për secilën nga këto armë;

c) numri dhe vendndodhja e magazinave;

d) masa të tjera, të cilat sipas mendimit të SACEUR, janë me rëndësi për arritjen e një gjendjeje logjistike në kohë paqeje që e pajis më mirë Aleancën për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase një emergjence.

Kjo nuk nënkupton në asnjë mënyrë që SACEUR do të ketë çfarëdo autoriteti mbi Agjencinë.

4. Në kohë paqeje, bordi i drejtorëve dhe SACEUR do të ngrenë bashkërisht dhe do të mirëmbajnë marrëdhëniet e personelit të nevojshme për të ndihmuar agjencinë që të vërë në jetë vendimet e bordit të drejtorëve dhe të sigurojë familjarizimin e kërkuar për kalimin drejt marrëdhënieve në kohë paqeje. Këto marrëdhënie të personelit nuk do të përdoren nga SACEUR si një mjet për rekomandimet e tij, të cilat duhet të dorëzohen siç parashikohet në paragrafin 3 më lart.

5. Në kohë krize ose lufte SACEUR do të jetë i përgatitur që të pranojë përgjegjësinë e formulimit të direktivave operacionale ndaj Agjencisë. Këto direktiva do të jenë në përputhje me vendimet e marra nga Këshilli i Atlantikut të Veriut në lidhje me logjistikën e NATO-s dhe për statusin e agjencive civile të NATO-s në kohë lufte. Procedura për zbatimin e këtyre direktivave do të përcaktohet bashkërisht nga bordi i drejtorëve dhe nga SACEUR. Këto përgjegjësi, megjithëse të planifikuara dhe të parashikuara në kohë lufte, do t'i kalojnë SACEUR vetëm me miratimin e duhur të Këshillit të Atlantikut të Veriut në kohën e krizave apo luftërave.

6. Për sa u përket financimeve, operacionet për mbështetjen logjistike të armëve të avancuara do të përcaktohen nga bordi i drejtorëve rast pas rasti. Sidoqoftë, bordi i drejtorëve do të marrë parasysh çfarëdo parimi financiar, të cilat mund të përcaktohen nga Këshilli i Atlantikut të Veriut në lidhje me mbështetjen logjistike.

7. Duke iu nënshtruar vendimeve të Këshillit të Atlantikut të Veriut vendimet që duhet të merren në lidhje me përgjegjësitë e DSACEUR mbi Identitetin Europian të Sigurisë dhe Mbrojtjes, SACEUR do të këshillojë NAMSOS nëse cilado nga përgjegjësitë e nënvizuara në këtë shtojcë i kalohet DSACEUR, në kohë krize ose lufte dhe NAMSOS do t'i përgjigjet DSACEUR në mënyrën e duhur.

## SHTOJCA II DISPOZITA E ARBITRAZHIT

1. Pala që fillon procedurat e arbitrazhit do të njoftojë palën tjetër me anë të një letre të regjistruar dhe me notë zyrtare që vërteton dërgimin, mbi dëshirën e saj për t'iu drejtuar arbitrazhit. Brenda një periudhe prej tridhjetë ditësh nga marrja e kësaj letre, palët do të caktojnë bashkërisht një arbitër. Në rastin kur ato nuk arrijnë të caktojnë një arbitër, mosmarrëveshja ose mosmarrëveshjet do t'i paraqiten një gjykatë arbitrazhi që përbëhet nga tre arbitra ku njëri emërohet nga Agjencia, një tjetër prej tyre nga pala tjetër kontraktuese dhe i treti, i cili do të veprojë edhe si kryetar i gjykatës, nga këta dy arbitra. Nëse njëra nga palët nuk arrin të caktojë një arbitër brenda pesëmbëdhjetë ditësh pas mbarimit të periudhës së parë prej tridhjetë ditësh ose nëse të dy arbitrat nuk mund të bien dakord për zgjedhjen e një anëtari të tretë të Gjykatës së Arbitrazhit, brenda tridhjetë ditësh nga mbarimi i periudhës së parë të parashtruar më lart, caktimi do të bëhet brenda njëzet e një ditësh, me kërkesën e palës që ka nisur procedurën, nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë.

2. Pavarësisht nga procedura në lidhje me caktimin e kësaj gjykatë arbitrazhi, arbitri i tretë duhet të jetë me shtetësi të ndryshme nga shtetësia e dy anëtarëve të tjerë të gjykatës.

3. Cilido arbitër duhet të ketë shtetësinë e cilitdo nga shtetet anëtare të NATO-s dhe do t'u nënshtrohet rregullave të sigurisë në fuqi brenda NATO-s.

4. Cilido person që del përpara Gjykatës së Arbitrazhit në cilësinë e një eksperti dëshmitar, nëse ai ka shtetësinë e njërit nga shtetet anëtare të NATO-s, do t'i nënshtrohet rregullave të sigurisë brenda NATO-s. Nëse ai ka një shtetësi tjetër, atij nuk do t'i komunikohet asnjë dokument apo informacion i klasifikuar i NATO-s.

5. Një arbitër, i cili për çfarëdo arsye rresht së vepruari si arbitër, do të zëvendësohet sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 1 më lart.

6. Gjykata e Arbitrazhit do të marrë vendim me shumicë votash. Ajo do të vendosë se ku do të mblidhet dhe përveç kur ajo vetë vendos ndryshe, do të ndjekë procedurat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë që janë në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.



7. Vendimet e Arbitrit ose të Gjykatës së Arbitrazhit janë përfundimtare dhe nuk do të ketë asnjë të drejtë ankimi apo rekursi të çfarëdolloji. Këto vendime do të përcaktojnë ndarjen e shpenzimeve të arbitrazhit.

### SHTOJCA III AUDITIMI I LLOGARIVE

1. Bordi Ndërkombëtar i Auditorëve për NATO-n, duke vepruar në emër të Këshillit të Atlantikut të Veriut, do të auditojë llogaritë e NAMSO-s. Ky auditim do të mbulojë të gjitha llogaritë e NAMSO-s, qofshin ato operacionale apo administrative. Buxheti operacional do të auditohet me synimin për të vërtetuar se operacionet e NAMSO-s janë kryer në mënyrën më ekonomike dhe brenda termave të buxhetit të miratuar.

2. Raporti i bordit ndërkombëtar të auditorëve për NATO-n do t'i paraqitet bordit të drejtorëve për vendim; një kopje e këtij raporti do t'i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për informim. Bordi i drejtorëve do t'ia përcjellë këtë raport dhe shtojcat e tij, bashkë me komentet e veta, Këshillit të Atlantikut të Veriut.

3. Shpenzimet e përbashkëta që rrjedhin nga ky sistem auditimi do të përballohen nga buxheti i NATO-s, sipas kushteve që për momentin rregullojnë auditimin e llogarive të personelit ndërkombëtar dhe shtabet e ndryshme.

4. Dispozitat e rregulloreve financiare të NATO-s, të cilat lidhen me detyrimet e Bordit Ndërkombëtar të Auditorëve për NATO-n dhe me auditimin e llogarive do të jenë në parim të zbatueshme. Sidoqoftë, për rregullimet e kërkuara për të plotësuar nevojat e veçanta të NAMSO-s do të bihet dakord bashkërisht nga Bordi Ndërkombëtar i Auditorëve për NATO-n dhe nga bordi i drejtorëve.

### SHTOJCA IV EKSTRAKT NGA BASHKËLIDHJA 1 E SHTOJCËS SË AC/35-D/2003 DIREKTIVA E KOMITETIT TË SIGURISË SË NATOS MBI SIGURINË INDUSTRIALE ZYRA E SIGURIMIT TË NATO (NOS)

#### 3. NOS:

a) do të ndihmojë dhe do të japë udhëzime në çështjet e sigurisë industriale ndaj NPLO-ve dhe projekteve të tjera industriale të NATO-s, siç mund të caktohet nga Këshilli dhe do të mbikëqyrë vënien në jetë të politikave dhe procedurave të sigurisë së NATO-s në ato organizata dhe projekte;

b) në marrëveshje me NSA/DSA<sup>7</sup> të shteteve anëtare të interesuara, do të ndihmojë dhe do të japë udhëzime ndaj NSA/DSA të tjera në vënien në jetë të politikave dhe procedurave të sigurisë së NATO-s në lidhje me veprimtaritë e NPLO-ve;

c) në marrëveshje me NSA/DSA të shteteve anëtare të interesuar, do të ndihmojë dhe do të japë udhëzime ndaj NSA/DSA të tjera në vënien në jetë të politikave dhe procedurave të sigurisë së NATO-s ndaj mjediseve që bëhen pjesë në veprimtaritë e NPLO-ve;

d) do të bëjë inspektime periodike mbi rregullimet e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s në NPLO-të;

e) në marrëveshje me NSA-në e duhur, do të bëjë shqyrtime periodike të masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s në DSA-të e vendeve anëtare përgjegjëse për veprimtaritë e NPLO-ve;

f) me miratimin e NSA/DSA të interesuara, do të bëjë shqyrtime periodike të masave të sigurisë në mjediset kombëtare vendase të përfshira në kontratat industriale të klasifikuara të NATO-s, të administruara nga një Agjenci / Zyrë e NATO-s për Administrimin e Projektit; dhe

---

<sup>7</sup> Shënim sekretarial: NSA nënkupton autoritetet e sigurimit kombëtar; DSA nënkupton autoritetet e caktuara për sigurinë.

g) do të japë udhëzime dhe këshilla, kur t'i kërkohet nga NSA/DSA, mbi çështje të sigurisë industriale që rrjedhin nga të gjitha projektet që kanë lidhje me NATO-n.

**UDHËZIM**  
**Nr.1, datë 22.11.2010**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.428, DATË 9.6.2010**  
**“PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET APO**  
**TRANSFORMOHET DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 13, kreu IV, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave nxjerrin këtë

**UDHËZIM:**

1. Në zbatim të pikës 1, kapitulli I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, të gjitha miratimet për privatizim, të nxjerra përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, do të konsiderohen të vlefshme.

2. Në zbatim të pikës 2, kapitulli I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore dërgojnë prononcimin e tyre për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo institucioneve, në administrim apo pronësi të tyre, në ministrinë përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore. Për të përfshirë në procesin e privatizimit pronat, të cilat i kanë kaluar në pronësi pushtetit vendor, nevojitet miratimi përkatës i këshillit bashkiak/komunës apo qarkut, ndërsa për pronat të cilat janë në administrim të këtyre institucioneve, nevojitet vetëm miratimi i kryetarit të bashkisë/ komunës apo qarkut përkatës.

3. Dega e shoqërisë publike në prefekturën përkatëse, me administrimin e miratimit për përfshirjen në procedurë privatizimi të objektit, vendos një njoftim në objekt, si dhe mjediset e organit të qeverisjes vendore (bashki-komunë), në territorin e të cilit ndodhet objekti, për efekt të ish-pronarëve nëse ka.

4. Vlerësimi i pasurisë shtetërore në zbatim të këtij vendimi bëhet për çdo element të pasurisë nga komisioni i vlerësimit, duke përcaktuar vlerën reale të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

5. Komisioni i vlerësimit për pasuritë e paluajtshme ngrihet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe do të përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, nga të cilët kryetari i degës së shoqërive publike në prefekturën përkatëse ku ndodhet objekti me cilësinë e kryetarit, përfaqësues i ndërmarrjes apo të institucionit në administrim të të cilit ndodhet objekti me cilësinë e anëtarit, si dhe eksperti vlerësues i licencuar, anëtar. Në rast se ministri përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore e gjykon të nevojshme, përfshin në komisionin e vlerësimit edhe ekspert kontabël të autorizuar apo ekspertë të tjerë të fushave përkatëse, sipas rastit. Për objektet, të cilat nuk kanë organ varësie apo organi varësisë nuk ekziston më, atëherë ministri përgjegjës për privatizimin, urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit.

6. Miratimi për përfshirjen në procesin e privatizimit të pasurisë së luajtshme, si elemente të veçanta, bëhet nga institucioni përkatës i varësisë administrative. Pas nxjerrjes së miratimit të privatizimit, ky institucion ngre komisionin e vlerësimit, i cili kryen vlerësimin e pasurisë. Ky komision duhet të ketë jo më pak se 3 anëtarë, kryesohet nga përfaqësuesi përkatës i strukturës

administrative dhe në përbërje të tij duhet të ketë një ekspert vlerësues të fushës përkatëse. Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e ekspertëve etj.) në rastin e mësipërm mbulohen nga institucioni ose ndërmarrja në administrim të të cilit ndodhet pasuria.

7. Ekspertët në përbërje të komisionit, të cilët hartojnë aktet vlerësuese, situacionet, genplanet etj., si dhe komisioni i vlerësimit mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë e vlerësimit të kryer prej tyre, si dhe për hartimin e dokumentacionit të nënshkruar prej tyre.

8. Ekspertët në përbërje të komisionit të vlerësimit të pronës së paluajtshme shtetërore përzgjidhen nga ministri përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore. Pagesa e tyre kryhet nga ministria përgjegjëse për privatizimin, përveç rasteve kur ministri përkatës urdhëron pagesën nga institucione të tjera. Kjo pagese do të jetë 2% e vlerës së objektit, apo grup-objekteve të vlerësuara, sipas dokumentacionit të vlerësimit të dërguar për shitje, por në çdo rast kjo pagesë nuk do të jetë më pak se 60 000 lekë dhe jo më shumë se 300 000 lekë. Kontrata e pagesës së ekspertëve vlerësues nënshkruhet nga drejtori i Administrimit të Pronës Publike në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Për ato vlerësime të kryera nga ekspertët vlerësues përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010, për të cilat dosjet e vlerësimit janë dërguar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për vazhdimin e procedurës së shitjes në Ministrinë e Financave, dhe për të cilat nuk janë lidhur kontratat e pagesës përkatëse me ekspertët, kontratat e pagesës do të lidhen sipas kushteve të këtij vendimi, nga i njëjti autoritet i cituar më sipër.

9. Komisioni i vlerësimit, me marrjen e miratimit për privatizim, inspekton dhe verifikon gjendjen reale të objektit. Në rastin e vlerësimit të objekteve që do të përfshihen në fondin e kompensimit fizik për ish-pronarët, pagesa e ekspertëve do të bëhet sipas procedurës së mësipërme. Pagesa në të dy rastet e mësipërme do të kryhet nga të ardhurat e marra nga privatizimi dhe dhënia me qira e pronës shtetërore nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

10. Pagesa e ekspertëve për vlerësimin e pasurive të shoqërive tregtare shtetërore, të formës anonime ose me përgjegjësi të kufizuar, mbulohet nga shoqëritë përkatëse. Në rast mospagese nga ana e shoqërisë, atëherë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës merr përsipër pagesën e ekspertëve, e cila është 2% e vlerës së paketës së aksioneve apo kuotave shtetërore që dalin në privatizim, por gjithmonë kjo vlerë nuk mund të jetë më e madhe se 500 000 lekë. Në këtë rast, kontrata e pagesës së ekspertëve firmoset sipas pikës 8 të këtij udhëzimi.

11. Trualli që privatizohet konsiderohet sipërfaqja nën objekt dhe sipërfaqja funksionale rreth tij, e përcaktuar sipas genplanit të objektit që është pjesë e dokumentacionit të privatizimit që përgatit komisioni i vlerësimit të ndërmarrjes sipas pikës 3, 4, 5 të kreut II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010.

12. Në zbatim të pikave 3, 4 dhe 5 të kapitullit II, genplani përgatitet nga eksperti vlerësues i licencuar i pasurisë së paluajtshme. Është përgjegjësi ligjore e hartuesve të genplanit saktësia e matjeve teknike të kryera. Me përgatitjen e genplanit eksperti përkatës e dorëzon atë menjëherë pranë kryetarit të komisionit në DSHP-në përkatëse.

13. Kryetari i degës së shoqërive publike dërgon kërkesën për konfirmimin e genplanit në prefekturën përkatëse, shoqëruar me pesë kopje origjinale të këtij genplani.

14. Prefekti autorizon një përfaqësues, i cili nënshkruan genplanet e objekteve të kërkuara nga dega e shoqërive publike.

15. Institucioni i prefektit, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së degës së shoqërive publike, konfirmon genplanin e objektit, duke nënshkruar e vulosur atë në pesë kopje origjinale dhe ia dërgon degës së shoqërive publike të shoqëruar me shkresën përcjellëse.

16. Menjëherë pas administrimit të kopjeve të genplanit të konfirmuara nga prefektura përkatëse, kryetari i degës së shoqërisë publike, i kërkon zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme përkatëse, hartën treguese të objektit që do të privatizohet. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, i dërgon degës së shoqërisë publike hartën treguese me të dhënat përkatëse për objektin dhe truallin, i cili përfshihet në proces privatizimi, si dhe çdo informacion të nevojshëm që ka të regjistruar në lidhje me këtë pronë, certifikatën e pronësisë/vërtetimin e pronësisë, nëse ka.

17. Në zbatim të pikës 8 në kreun II, komisioni i vlerësimit, pas marrjes së dokumentacionit nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konfirmimin nëse trualli përkatës ka pronarë të njohur apo të kthyer me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe çmimin përkatës të truallit ku ndodhet objekti, sipas hartës së çmimeve të miratuar me vendim të Këshillit Ministrave në fuqi. Në rastet kur ky çmim nuk ekziston, eksperti/ët vlerësues të caktuar për vlerësimin e pronës, përcakton/jnë çmimin aktual të tregut të shitjes së truallit të objektit që do të privatizohet.

18. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda 10 ditëve nga administrimi kërkesës nga dega e shoqërisë publike, i dërgon kësaj të fundit çmimin përkatës të shitjes së truallit të objektit që privatizohet të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe vendimet përkatëse të kthimit dhe kompensimit të pronave nëse ka shoqëruar me vulë lidhëse me planvendosjen e saktë të pronës, ku të jetë përcaktuar qartë kufiri i pronës, si dhe çdo informacion shtesë që lidhet me vendimin përkatës të kthimit dhe kompensimit të pronave. Ky institucion mban përgjegjësi ligjore për mosrespektimin e afatit të mësipërm.

19. Në zbatim të pikës 12, kreu II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010, për rastet e privatizimit tërësor të ndërmarrjeve, të linjave të shërbimit dhe të prodhimit, të objekteve, së bashku me makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros etj., që janë pjesë përbërëse të objektit: dokumentacioni i vlerësimit të objekteve ndërtimore të veçanta, pasi të kenë kaluar të gjitha procedurat, do të dërgohen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike). Ndërsa dokumentacioni i vlerësimit të pasurive të luajtshme, si makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, mjetet e xhiros etj., që privatizohen të veçuara, pasi përgatitet nga komisioni i vlerësimit, përcillet prej tij në degën e shoqërive publike përkatëse, e cila pas kontrollit e dërgon në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike).

20. Dokumentacioni i vlerësimit të objekteve duhet të përmbajë shkresën përcjellëse të degës së shoqërive publike përkatëse, relacionin e komisionit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët, raportin e vlerësimit të hartuar nga eksperti/ët dhe të nënshkruar prej tyre, shkresën e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, së bashku dokumentacionin plotësues nëse ka, shkresën e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe dokumentacionin plotësues nëse ka, miratimi i privatizimit, shkresa për ngritjen e komisionit të vlerësimit, si dhe genplani përkatës i konfirmuar nga prefektura.

21. Vlerësimi i aseteve, për kontratat e shitjes, të cilat janë shpallur të pavlefshme nga gjykata, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme dhe dosjet e tyre janë kthyer në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Financave, bëhet nga komisioni i vlerësimit, i ngritur për këtë qëllim nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës sipas gjendjes faktike të tyre, duke përcaktuar vlerën e tregut.

22. Pas administrimit të dokumentacionit të vlerësimit të pronës të dërguar nga dega e shoqërive publike në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, strukturat përkatëse të kësaj të fundit të ngarkuara me punë për këtë qëllim, kryejnë verifikimin nëse ky dokumentacion ka kaluar në hallkat përkatëse sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 dhe këtë udhëzim dhe nëse e gjejnë atë të rregullt, përgatitin praktikën përkatëse për ta përcjellë atë në Ministrinë e Financave për realizimin e procedurave të shitjes.

23. Në zbatim të pikës 2, germa “a”, kreu III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, për rastet e shitjes së objekteve për të cilat është konfirmuar se ka pronar truall, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave afishon njoftimin në ambientet e saj, ndërsa dega e shoqërive publike përkatëse (sipas të dhënave të dërguara nga DASHPP-ja) në objekt dhe ambientet e ndërmarrjes që e administron atë.

Ish-pronari i truallit që dëshiron të blejë objektin apo çdo subjekt tjetër që në bazë të dokumenteve që disponon, pretendon të ketë pronësi mbi truallin e objektit që privatizohet, duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, brenda një afati 20-ditor nga dita e publikimit (afishimit) duke depozituar:

- kërkesën me shkrim, në të cilën shprehet se dëshiron të blejë objektin e publikuar për shitje;

- dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20% të vlerës totale të objektit (mjete kryesore + mjete xhiro), pa vlerën e truallit të objektit që kërkon të blejë;

- vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve të noterizuar, të shoqëruar me planvendosjen e pronës;

- çdo dokument tjetër ligjor të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i cili përcakton se ai është pronar i tokës;

- dëshmi trashëgimie;

- prokurë të posaçme përfaqësimi dhe marrëveshje të dokumentuar midis bashkëpronarëve, kur ka të tilla.

24. Në rast se ish-pronari i truallit (trashëgimtarët e tij), sipas përcaktimit të pikës 2, germa “a” dhe “b”, kapitulli III, të këtij vendimi, nuk paraqitet për blerjen e objektit që ndodhet në truallin e tij, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave realizon shitjen me ankand të objektit dhe të truallit, sipas procedurave të këtij vendimi. Vlera e truallit, e përcaktuar sipas hartës së vlerës dhe që ndodhet në dosjen e vlerësimit të objektit, do të përdoret drejtpërsëdrejti për të kompensuar ish-pronarin.

25. Në rast se në procedurat e shitjes së objektit shprehet interes për blerje vetëm nga një ose një pjesë e trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit, të përcaktuar në dëshminë e trashëgimisë, atëherë e drejta e parablerjes dhe gjithë të drejtat dhe detyrimet sipas këtij vendimi, realizohen nga trashëgimtari/rët që kanë shprehur interesin dhe shitja bëhet në favor të këtyre të fundit, ndërsa marrëdhëniet e bashkëpronësisë dhe detyrimet reciproke midis të gjithë trashëgimtarëve u nënshtrohen dispozitave të Kodit Civil.

26. Kur objekti është me dy a më shumë kate dhe në të ka disa pronarë, atëherë shitja e truallit në bazë të kërkesës së tyre për çdo pronar bëhet në bashkëpronësi të pandashme mes pronarëve të objektit. Bashkëpronarët u nënshtrohen dispozitave të Kodit Civil. Këto sipërfaqe, të cilat përcaktohen nga ekspertët vlerësues, duke u shumëzuar me çmimin për m<sup>2</sup> të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, japin vleftën që duhet të paguajë në lekë secili pronar.

27. Në bazë të përcaktimit të pikës 2, germa “c”, kapitulli III, të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave konfirmon dokumentacionin e pronësisë të depozituar nga pronarët e truallit, pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo çdo institucion tjetër që e konfirmon këtë dokumentacion.

28. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, për rastet e shitjes së objektit personave të tretë nëpërmjet ankandit apo të pasurive të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteozë, kur ka të identifikuar pronarë trualli, për vlerën e truallit të shitur, njofton me shkrim sektorin e financës dhe buxhetit në Ministrinë e Financave, e cila duhet të derdhë, në favor të pronarit të truallit vlerën e truallit përkatës për kompensim financiar. Njoftimit me shkrim duhet t’i bashkëlidhet dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për ish-pronarin apo çdo dokument tjetër ligjor të regjistruar në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që vërteton se ai është pronar i tokës;

- Kontrata e shitjes së objektit bashkë me truallin;

- Autorizimi për kalim pronësie;

- Mandatpagesat që lidhen me pagesat e truallit.

Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, për realizimin e procedurës së mësipërme, njëkohësisht me njoftimin e sipërcituar, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konfirmim, nëse ish-pronari (trashëgimtarët e tij) kanë përfituar ose jo më parë kompensim financiar apo fizik mbi bazën e vendimit me të cilin është njohur prona ku ndodhet objekti i privatizuar, si dhe informacion mbi vlefshmërinë e vendimit përkatës.

Ish-pronari i truallit që do të përfitojë kompensim financiar duhet të paraqesë në Ministrinë e Financave (sektori i financës dhe buxhetit) dokumentacionin ligjor, si më poshtë:

- Kërkesën me shkrim për kompensim financiar për truallin ish-pronë e tij;
- Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë);
- Dëshmi trashëgimie;
- Prokurë të posaçme përfaqësimi, ku të jetë përcaktuar tagra e trajtimit financiar;
- Numrin e llogarisë personale të hapur pranë Raiffeisen Bank apo çdo banke tjetër e nivelit të dytë;
- Deklaratë noteriale që nuk ka përfituar kompensim financiar apo fizik për pronën truall njohur me vendimin përkatës.

29. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pas njoftimit të marrë nga sektori i financës dhe buxhetit në Ministrinë e Financave, njofton me shkrim Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kompensimin financiar të kryer në favor të subjekteve të shpronësuara, jo më vonë se 5 ditë nga data e realizimit të kompensimit financiar.

30. Në rastet kur konfirmohet se objekti nuk ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuara, apo në rastet kur Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike nuk ka informacion për këtë qëllim, objekti i nënshtrohet ankandit sipas procedurave të këtij vendimi dhe në qoftë se gjatë periudhës së publikimit apo ditën e zhvillimit të ankandit paraqitet subjekti i shpronësuar (pronar i truallit) me dokumentet përkatëse të pronësisë, atëherë ai gëzon të drejtën e parablerjes së objektit me vlerën fillestare të tij. Në këto raste komisioni i ankandit administron kërkesat e paraqitura për blerjen e objektit, si dhe dokumentacionin e pronësisë të paraqitur nga subjektet e shpronësuara pretendente për pronarë truall të objektit që privatizohet dhe shtyn procedurën e zhvillimit të ankandit me miratim të drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, deri në konfirmimin e dokumentacionit të pronësisë së truallit nga organet përkatëse, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo çdo institucion tjetër shtetëror që e disponon dhe e konfirmon atë dokumentacion. Nëse pretendimet e paraqitura në kërkesë të pronarit të truallit konfirmohen nga organet përkatëse, atëherë do të veprohet sipas kreut III, pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010. Pjesëmarrësit e tjerë të paraqitur për blerje me ankand u kthehet brenda 10-ditëve, pagesa e 20% të vlerës e depozituar për pjesëmarrje në ankand.

31. Kur ish-pronari i truallit është pronar i objektit duke përdorur të drejtën e parablerjes sipas pikës 2, germa "a", kapitulli III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010, truall kalon në favor të tij pa shpërblim.

32. Në zbatim të pikës 16, kreu III, të këtij vendimi, për rastet kur në ankandin për shitjen e objekteve apo asetëve me vlerë fillestare dhe me vlerë të ulur paraqitet vetëm një kërkesë përpara komisionit të ankandit, komisioni duhet ta evidentojë këtë kërkesë në procesverbalin e ankandit dhe objekti t'i nënshtrohet procedurës së ripublikimit për një periudhë 10-ditore në një gazetë me qarkullim kombëtar dhe me afishe, në ambientet e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe në rast të mosparaqitjes të kërkesave të tjera edhe pas këtij publikimi, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike realizon shitjen e objektit bashkë me truallin kërkesës së vetme të paraqitur për blerje.

33. Në zbatim të pikës 12, kapitulli II, të këtij vendimi, me mbërritjen e dokumentacionit të privatizimit për shitjen e makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike realizon publikimin sipas pikës 6, kapitulli III, të këtij vendimi, si dhe afishon njoftimin në ambientet e saj dhe një kopje të afishimit e dërgon në degën e

shoqërive publike të prefekturës ku ndodhet ndërmarrja që i ka në administrim ato për t'i afishuar në ambientet e saj.

34. Në zbatim të pikës 5, kreu III, të këtij vendimi, ankandi do të zhvillohet mbi vlerën e mjeteve kryesore + vlera e truallit, ndërsa vlera e mjeteve të xhiros do të shtohet sipas inventarit fizik, në çastin e dorëzimit të objektit.

35. Gjithashtu, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, me urdhër të drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, si dhe me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mund të përdorë edhe forma të tjera publikimi në media televizive e shkruar, postera etj. Shpenzimet e publikimit do të përballohen nga të ardhurat e privatizimit.

36. Në zbatim të pikës 10, kapitulli III, pjesëmarrësit në ankand në vendin, datën dhe orën e njoftuar duhet të paraqesin pranë komisionit të ankandit edhe dokumentin e identifikimit të tyre (letërnjoftim, pasaportë). Gjithashtu në garancinë (apo në mandatpagesën) që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit duhet të jetë përcaktuar qartë qëllimi i këtij transaksioni, si dhe të garantojë kalimin e shumës në llogari të Ministrisë së Financave. Të drejtën e paraqitjes për blerje të objektit, së bashku (në bashkëpronësi) me një kërkesë të vetme e kanë edhe më shumë se një person. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me dokumentin bankar që përmban emrat e personave që bashkohen në këtë blerje. Në rast të paraqitjes së një blerësi, personat e tjerë kërkues duhet të përfaqësohen me prokurë të posaçme.

37. Në zbatim të kreu III të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010, ish-pronarët e truallit, të cilët janë shpallur fitues me të drejtën e parablerjes për objektet, gëzojnë të drejtën që 80% të vlerës së objektit ta paguajnë me letra me vlerë dhe bono privatizimi, nga i cili 20% është paguar me lekë *cash*, për para lëshimit të autorizimit për kalimin e pronësisë. Pagesat me lekë *cash* për pjesëmarrje në blerjen e objektit bëhet në Raiffeisen Bank dhe në çdo bankë të nivelit të dytë, ndërsa pagesa me letra me vlerë dhe bono privatizimi do të bëhet vetëm pranë Raiffeisen Bank në numrat e llogarisë të afishuara në dokumentacionin e shitjes nga Ministria e Financave (DASHPP) për llogari të kësaj ministrie. Raiffeisen Bank, të gjitha letrat me vlerë dhe bonot e privatizimit për efekt privatizimi, sipas kësaj pike, do t'i bëjë ato të pavlefshme dhe në fund të çdo 6-mujori do t'i dorëzojë në Bankën e Shqipërisë.

38. Në rastin kur është konfirmuar në dosjen e vlerësimit apo kur subjektet e shpronësuara të truallit të objektit kanë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë dhe kërkesën për blerjen e objektit sipas pikës 11 të kapitullit III, por nuk paraqiten në ankandin e objektit që ndodhet në pronën e tyre, komisioni i ankandit evidenton kërkesat për blerje në procesverbalin përkatës dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda shtatë ditëve nga data e mëparshme e zhvillimit të ankandit, duke njoftuar edhe një herë pronarët e truallit. Nëse edhe në këtë datë pronarët e truallit nuk paraqiten për blerjen e objektit me të drejtën e parablerjes, atëherë Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike do të veprojë sipas pikës 2, germa "b", kapitulli III, të këtij vendimi.

39. Në zbatim të pikës 26, kreu III, personi që ka fituar të drejtën e blerjes për objektin dhe nuk paguan vlerën e plotë të tij brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij si fitues ankandi apo pronar truall, humbet vlerën prej 20% të paguar për pjesëmarrje në ankand, si dhe të drejtën për të marrë pjesë përsëri në ankandin që do të zhvillohet për rishitjen e objektit në fjalë.

40. Në zbatim të pikës 33 dhe 34 të kapitullit III, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, sektori përkatës që monitoron zbatimin e kontratave të qerasë, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i paraqet për miratim Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës vlerën e investimeve të kryera nga qiramarrësi dhe të vlerësuar nga ekspertët përkatës, vlerë kjo, e cila duhet të jetë mbi 150% e vlerës së truallit, të përcaktuar sipas çmimit të truallit të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe sipërfaqes së truallit në kontratën e qiramarrjes. Në këtë propozim, që i paraqitet, dhe fakti që subjekti kërkues nuk ka detyrime nga shtetit.

41. Pas miratimit të vlerës së investimeve të përcaktuara më sipër, sektori përkatës që monitoron zbatimin e kontratave të qirasë, nëpërmjet aktit të brendshëm përcjell praktikën përkatëse të miratuar, pranë sektorit/njësisë përkatëse në METE që merren me iniciimin, ndjekjen e

procedurave të privatizimit, për vazhdimin e procedurës së mëtejshme. Pas administrimit të praktikës, ministri nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit në favor të investitorit.

42. Shitja e pasurive shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteozë, sipas përcaktimit në pikën 34, kapitulli III, të këtij vendimi, realizohet nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike njofton me shkrim subjektin që ka pasurinë shtetërore me kontratë qiraje apo enfiteozë, në të cilin i kërkon që brenda 20 ditëve nga data e njoftimit, të shprehë interesin për blerjen e objektit bashkë me truallin. Në këtë njoftim duhet të jetë përcaktuar dokumentacioni që qiramarrësi apo enfiteozmarrësi duhet të paraqesë për shprehjen e interesit për blerjen e objektit, si më poshtë:

- Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit bashkë me truallin që ai ka me qira apo enfiteozë.

- Pagesën e vlerës prej 20% të vlerës së objektit + vlerën e mjeteve të xhiros, nëse ka, dhe + vlerën e truallit.

- Kopje të noterizuar të kontratës së qirasë apo të enfiteozës për objektin. Nëse qiramarrësi apo enfiteozmarrësi është shoqëri tregtare, dokumentacionin ligjor të shoqërisë.

- Me plotësimin e dokumentacionit të mësipërm nga subjekti qiramarrës apo enfiteozmarrës, dorëzimin e tyre në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, kjo e fundit pajis subjektin me autorizim për kalim pronësie, në të cilin duhet të jenë të përcaktuar qartë detyrimet e blerësit.

43. Pagesa e vlerës së plotë të objektit dhe e truallit për pasuritë shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteozë do të bëhet vetëm me lekë *cash*. Kontrata e shitjes së truallit do të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes së objektit.

44. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, për raste kur në dokumentacionin e vlerësimit të objektit të dërguar për privatizim nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës konstaton mospërputhje të hartës treguese me genplanin e dosjes apo konstaton mungesa të të dhënave hartografike në HTR etj., kërkon informacion plotësues nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

45. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes” dhe këtij udhëzimi për zbatimin e këtij vendimi, ka të drejtë të hartojë dhe të miratojë rregulloren e brendshme për zhvillimin e ankandit, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës në përputhje të akteve ligjore në fuqi, për të rritur efikasitetin e privatizimit.

46. Publikimi për shitje për objektin që do të privatizohet, përveç informacionit plotësues të përcaktuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike përmban edhe tabelën me të dhënat, sipas formatit si më poshtë:

Numri rendor	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlera fillestare e objektit (lekë) (mjete kryesore + mjetet e xhiros + vlera e truallit)	Mjete xhiroje (në lekë)	Sipërfaqja gjithsej e objektit (në m <sup>2</sup> )	Sipërfaqja nën objekt (në m <sup>2</sup> )	Vlera e truallit (në lekë)
1							
2							
3							
4							

47. Për rastet e publikimit (afishimit) për ish-pronarët e truallit, tabela do të jetë me të dhënat e mëposhtme:



Numri rendor	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlera fillestare e objektit (lekë) (Mjete kryesore + mjetet e xhiros)	Mjete xhiroje (në lekë)	Sipërfaqja gjithsej e objektit (në m <sup>2</sup> )	Sipërfaqja nën objekt (në m <sup>2</sup> )	Vlera e truallit (në lekë)
1							
2							
3							
4							

48. Në zbatim të pikës 18, kreu III, të këtij vendimi, dokumentacionet e vlerësimit të objekteve ndërtimore të pashitura, pas zbatimit të të gjitha fazave të shitjes sipas këtij vendimi, do të përcillen në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe kjo e fundit i dërgon pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për t'u përdorur si fond kompensimi fizik. Ndërsa dosjet e vlerësimit të makinerive, pajisjeve etj., të cilat kanë mbaruar procedurën e privatizimit dhe rezultojnë të pashitura, kthehen në degën e shoqërive publike të prefekturës përkatëse, dhe kjo e fundit i kthen në ndërmarrje apo institucionin e varësisë administrative, i cili zbaton procedurat përkatëse ligjore të nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre.

49. Në zbatim të pikës 32, kapitulli III, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dërgon në datën 20 të çdo muaji në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës evidencën statistikore të shitjeve.

50. Në zbatim të pikës 14, kapitulli IV, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010, për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen institucionet publike të përmendura në këtë udhëzim.

51. Udhëzimet e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Financave nr.385, datë 16.1.2009 dhe nr.156, datë 27.2.2009 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes””, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS  
**Illir Meta**

MINISTRI I FINANCEVE  
**Ridvan Bode**

**Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.**

**Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 10.12.2010

Doli nga shtypi më 13.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë